



STATUTI

MIRATUAR NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

TIRANË

Datë 30.01.2021



STATUTI FEDERATA SHQIPTARE E BASKETBOLLIT

KREU I

Neni 1

Forma e organizimit

1. **Federata Shqiptare e Basketbollit**, është person juridik, krijuar në formën e shoqatës, anëtarë të së cilës janë shoqatat sportive, shoqërítë sportive dhe klubet sportive që ushtrojnë veprimtari në sportin e basketbollit. Ajo ka për qëllim organizimin, zhvillimin, promovimin, kontrollin, rregullimin dhe përhapjen e sportit të basketbollit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe përfaqësimin e vendit në arenën ndërkombëtare.
2. **Federata Shqiptare e Basketbollit**, është organ i pavarur nga ideologjitet, me qëllime jo fitimprurëse, jashtë partive politike.
3. **Federata Shqiptare e Basketbollit** është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA) nga 25 Prill 1947 dhe si e tillë, zbaton statutin e saj, të gjitha rregulloret zyrtare, direktivat dhe vendimet e FIBA-s, duke kërkuar respektimin dhe zbatimin e tyre nga të gjithë anëtarët e saj.
4. Veprimitaria e **Federatës Shqiptare të Basketbollit**, zhvillohet në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj. Akteve të cilat miratohen në mënyrë të rregullt prej organeve vendimarrëse sipas përcaktimeve në rregullore dhe statut. Rregulloren dhe Statutin e Federatës Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA), Kodin Civil në fuqi, ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “**Për Organizatat Jofitimprurëse**”, ligjin nr. 8789, datë 03.05.2001 “**Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse**”, ligjin Nr. 79/2017 “**Për sportin**” i ndryshuar dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Emri, Logoja, Vula dhe Flamuri

1. **Emri i shoqatës** është: **Federata Shqiptare e Basketbollit**. Ky emër do të figurojë në të gjitha shkresat dhe korrespondencat zyrtare. Emërtimi i shkurtuar është **FSHB**.

President
Avni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani



1



2. **Logoja e FSHB-së** përbëhet nga një top basketbolli me ngjyrë portokalli, i cili duke lëvizur në drejtim të koshit, lë një gjurmë me ngjyrë portokalli. Mbi rrjetën e koshit është vendosur shqiponja e flamurit kombëtar. Në krahun e majtë të koshit, poshtë gjurmës së topit shkruhet me gërma të mëdha dhe me ngjyrë të kuqe FSHB. Poshtë shkrimit FSHB, shkruhet me gërma kapitale ALBANIAN BASKETBALL FEDERATION.
3. **Vula e FSHB-së** është në formë të rrumbullakët me mbishkrimin "Federata Shqiptare e Basketbollit" dhe në mesin e saj ka një top basketbolli me logon e FSHBse mbi të.
4. **Flamuri i FSHB-së** është me sfond të bardhë, në pjesën e sipërme të të cilit shkruhet me gërma kapitale FEDERATA SHQIPTARE E BASKETBOLLIT dhe poshtë saj ALBANIAN BASKETBALL FEDERATION. Në mesin e tij është logoja e FSHB-së. Në pjesën e poshtme shkruhet viti i krijimit "1946". Në pjesën e pasme të flamurit ndodhet flamuri kombëtar.

Neni 3
Selia dhe vendi i zhvillimit të aktivitetit

1. Selia e FSHB-së ndodhet në: Rruga Xhorxh Bush, P.I, Shk.I, Banes Private Nr 2, Tiranë, Shqiperi. Numri i kontaktit është tel: +355693831611, web: www.fshb.basketball, email: info@fshb.basketball
2. FSHB e zhvillon veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Sipas marreveshjeve dhe partneriteteve ndërkombëtare, aktiviteti i saj mund të shtrihet në të gjitha vendet e tjera të botës.

Neni 4
Kohëzgjatja

FSHB do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor të papërcaktuar.

President
Avni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani



Neni 5
Qëllimi i përgjithshëm dhe objektivat specifike

1. Qëllimi i Federatës Shqiptare të Basketbollit është:

- a. Të zhvillojë dhe promovojë aktivitetin basketbollit në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar në të gjitha disiplinat dhe kategoritë.
- b. Të ndërmarrë iniciativa për organizimin e aktiviteteve, në zbatim dhe në përbushje të detyrimit ligjor. Të mbështesë objektiva, fushata, programe apo projekte të inicuara nga FIBA dhe/ose nga organizma të tjere.
- c. Të organizojë, administrojë dhe manaxhojë aktivitetetin e basketbollit në Shqipëri dhe si anëtare e FIBA-s, të marrë pjesë në garat dhe kompeticionet të organizuara prej saj, duke promovuar lojën e ndershme “fair play”.
- d. Të përgatisë ekipe kombëtare meshkujt dhe femra në basketboll, duke e përfaqësuar vendin në veprimtaritë ndërkombëtare duke respektuar legjislacionin në fuqi, Rregulloren dhe Statutin e FSHB-së dhe FIBA-s.
- e. Të promovojë veprimtaritë e basketbollit, duke nxitur masivizimin në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar duke kontribuar në organizimin dhe zhvillimin e shoqatave anëtare për të gjitha kategoritë dhe moshat.
- f. Të delegojë kompetencat për organizimin e aktiviteteve të ndryshme basketbollit anëtarve e saj, duke vlerësuar performancën dhe mundësinë e realizimit me sukses të veprimit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë statut, Rregulloreve të FIBA-s si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.


2 FSHB përbush qëllimet dhe objektivat e saj nëpërmjet:

- a. Bashkëpunimit dhe krijimit të një rrjeti lidhjesh me autoritetet qëndrore dhe vendore në fushën e sportit, FIBA-s dhe Federatave të vendeve të tjera, persona fizikë dhe juridikë, me institucionet publike dhe private brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me statutin e FSHB-së, legjislacionin në fuqi si dhe marrëveshjet ndërkombëtare për këtë qellim.

President
Avni Ponari



Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani




- b. Krijimit të kushteve të nevojshme për organizimin dhe zhvillimin sistematik, të veprimtarive basketbollistike nga të gjitha moshat në nivel kombëtar, të mbështetura nga institucionet e pushtetit qëndror dhe njësitet e qeverisjes vendore.
- c. Krijimit të mundësisë dhe mbështetjes për kualifikimin e trajnerëve, gjyqtarëve të tavolinës, gjyqtarëve të fushës, vëzhguesve, mbajtësve të statistikave. Ngritjen e kapaciteteve të shoqatave anëtare nepërmbajtës takimeve, trajnimeve dhe seminarëve në bashkëpunim me specialistë dhe institucionet e fushës, në bashkëpunim me partnerë vendas dhe të huaj.
- d. Mbështetjes brenda mundësive për krijimin, ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës sportive si në salla, palestra, pallate sporti, qëndra sportive, kënde sportive në ambjente publike dhe private, etj.
- e. Krijimit të qendrave dhe kanaleve të shkëmbimit të informacionit, botimit dhe publikimit të periodikeve, gazetave, revistave, transmetimeve audiovizive në rrugë ajrore, tokësore ose me çdo lloj mënyre tjetër, si dhe portaleve online. Rrjetet sociale, faqjes zyrtare elektronike, si dhe çdo element tjetër të medias virtuale të shkruar, që lidhet me marketingun sportiv, promovimin e sportit dhe talenteve, etj.

Neni 6 **Detyrat dhe aktivitetet**

1. **FSHB** në zbatim të detyrimit ligjor që ka, do të organizojë veprimtarinë e saj sipas programit vjetor. Ajo ka për detyrë të:

- a. Të organizojë, Kampionatin Kombëtar, Kupën e Shqipërisë, Superkupën, për meshkuj dhe femra (të rritur/a) si dhe kampionatet kombëtare, për të gjitha grupmoshat në nivel kombëtar. Aktivitetet 3x3, turne për grupet e marxhinalizuara dhe me aftësi ndryshe.
- b. Të shpallë kampion kombëtar dhe ekipet fituese në sportin e basketbollit për meshkuj dhe femra (rritur/a), si dhe për të gjitha grupmoshat deri tek kategorite në aktivitetet:

President
Ayni Ponari



Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani




- Kampionit Kombëtar (rritur/a)
- Kupës së Shqipërisë (rritur/a)
- Superkupës (rritur/a)
- Kampionatit Kombëtar U18 d-v
- Kampionatit Kombëtar U16 d-v
- Turnetë me grupmoshat (d-v)
- 3x3

2. FSHB duhet të:

- a. Të organizojë dhe të perfaqësojë vendin në nivel ndërkombëtar, në aktivitetet zyrtare dhe miqësore sipas kalendarit të përcaktuar nga FSHB dhe FIBA.
- b. Të autorizojë pjesmarrje në veprimitari ndërkombëtare anëtareve të saj.
- c. Të vëzhojë dhe monitorojë talentet e reja brenda dhe jashtë vendit, si dhe inkurajojë ato të bëhen pjesë e ekipeve kombëtare.
- d. Të monitorojë, menaxhojë të drejtat e pronësisë së lojtarëve sipas standardeve të FIBA-s.
- e. Të trajnojë dhe liçensojë trajnerët sipas kategorive dhe niveleve të sportit të basketbollit.
- f. Të zhvillojë publikimin dhe marketingut të sponsorëve që i afrohen FSHB-së, si dhe produkteve të tyre.
- g. Të kujdeset për transferimin e të drejtave televizive dhe të drejtës së reklamave ndaj sponsorëve dhe donatorëve të FSHB-së.
- h. Të organizojë zhvillojë dhe nxisë anëtarët në aktivitete edukuese dhe ndërgjegjësuese për promovimin e sportit dhe në mënyrë të veçantë basketbollit.
- i. Të mbështesë aktivitete kulturore, artisitike, sociale, aktivitetet informuese, ndërgjegjësuese, lobuese, si dhe aktivitete trajnuese për forcim kapacitetesh.
- j. Të nxisë bashkëpunimin dhe zhvillojë aktivitete të tjera në shërbim të arritjes së qëllimeve të ligjshme.
- k. Të aderojë në Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar

President
Avni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani





KREU II

ANËTARËSIA NË FEDERATËN SHQIPTARE TË BASKETBOLLIT

Neni 7 Anëtarësia

1. Anëtarë të FSHB-së, mund të jenë shoqatat sportive, shoqëritë sportive dhe klubet sportive të regjistruara që kanë fituar personalitet juridik sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe që ushtrojnë veprimtari në sportin e basketbollit dhe:
 - a. Selia e tyre ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 - b. Kanë jo më pak se dy ekipe pjesmarrëse në Kamp Kombëtare, U-16 dhe lart përmes meshkuj ose femra.
 - c. Paraqesin kërkesë zyrtare drejtuar KD-së dhe Asamblesë së FSHB-së për anëtarësim, duke deklaruar se aktiviteti i tyre do të zhvillohet në përpunje dhe zbatim të statutit dhe rregulloreve në fuqi të FSHB-së.
2. FSHB ka të drejtë të miratojë me Vendim të Asamblesë: Anëtarë të nderit, figura të shquara të basketbollit shqiptar, si ish lojtarë, ish trajnerë, ish gjyqtarë apo dhe donatorë dhe financies të basketbollit, etj.

Neni 8 Regjistrimi i anëtarëve

1. Çdo anëtar i FSHB-së, duhet të figurojë i regjistruar në regjistrin themeltar të saj dhe të pajiset me kartë anëtarësimi.
2. Në regjistrin e anëtarësimit duhet të shënohen data e anëtarësimit, data e largimit si dhe shkaqet e këtij largimi.
3. Karta e anëtarësimit duhet të firmoset nga Presidenti i FSHB-së dhe të ketë vulën e federatës (FSHB-së).

President
Avni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani





Neni 9 Të drejtat e anëtarit

1. Ushtrimin e të drejtës së anëtarësisë e gjëzon çdo anëtar që:

- Është pranuar në mënyrë të rregullt.
- Ka derdhur kontributin e anëtarësisë.
- Ka dredhur kuotën periodike në mbështetje të rregullores vjetore sipas pjesmarrjes në veprimtaritë e organizuara nga FSHB si anëtar.

2. Anëtari i FSHB-së ka këto të drejta:

- Të japë mendime, të propozojë dhe të marrë pjesë në votim për çdo çështje që diskutohet në asamblenë e FSHB-së.
- Të njihet me çdo vendim të marrë nga organet drejtuese të FSHB-së.
- Të propozojë dhe të zgjedhë kandidurat për në organet drejtuese të FSHB-së në bazë të proçedurave të përcaktuara.
- Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë, në aktivitete dhe veprimtari të FSHB-së.
- Të njihet dhe të kërkojë informacion në lidhje me administrimin e fondeve të FSHB-së.
- Të kërkojë mbështetje që të marrë përsipër organizimin e aktiviteteve të ndryshme në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- E drejta e votës së çdo anëtari përcaktohet sipas përshkrimit të bërë në nenin 19, pikën d, si dhe sipas përshkrimit të bërë në nenin 20 pika 3, i këtij statuti.
- Të marrë pjesë në mbedhjet e KD-së për çështje që dikutohen dhe kanë lidhje të drejtë përdrejta me të dhe me interesat e tij. Kur KD-ja e shikon të arsyeshme.

President
Avni Ponari



Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani

Neni 10
Detyrat e anëtarëve

1. Anëtari i Shoqatës ka këto detyra:

- a. Të zbatojë në mënyrë rigorozë Statutin dhe Rregulloren e FSHB-së.
- b. Të kontribuojë për prezantimin dhe mbështetjen e programit të FSHB-së dhe aktivitetin e saj.
- c. Të kontribuojë për organizimin e veprimtarive dhe aktiviteteve të FSHB-së.
- d. Të zbatojë detyrat e ngarkuara dhe të marra përsipër.
- e. Të paguajë kontributin e anëtarësisë dhe kuotën periodike vjetore të pjesmarrjes në veprimtari.
- f. Në pjesën qëndrore të aktiviteteve të organizuara prej tij, të vendose logon e FSHB-së dhe të sponsorëve të saj.
- g. T'i njoftojë menjëherë FSHB-së çdo ndryshim në statutin dhe rregulloret e veta sipas të gjitha procedurave ligjore.
- h. T'i përgjigjet në kohë kërkesave shkresore dhe administrative që kërkohen, në mënyre të arsyeshme në shërbim të mbarëvajtjes së punës.
- i. Të njoħej parimet e ndershmërisë, fair – play, intergritetit dhe sjelljes korekte sportive, në përputhje me Kartën Olimpike, Kodin Botëror të WADA-s dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 11
Detyrimet financiare të anëtarëve

1. Anëtarët kanë dy lloj detyrimesh financiare ndaj FSHB-së:

- a. Kuotën e pranimit të anëtarësisë në Lekë (sipas përcaktimit në Rregulloren e Aktiviteteve).
- b. Kuotën periodike vjetore të pjesëmarrjes në veprimtari në Lekë (sipas përcaktimit në Rregulloren e Aktiviteteve).

President
Avni Ponari



Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani





2. Kuotën e anëtarësimit dhe kuotat periodike vjetore mund të ndryshohen çdo vit nga Asambleja e Përgjithshme dhe te publikuara në Rregulloret e saj sezonale të miratuara nga Komiteti Drejtues.

Neni 12
Pezullimi dhe Humbja e cilësisë së anëtarit

1. Anëtar i FSHB-së humbet cilësinë e tij si anëtar, kur :
 - a. Heq dorë nga anëtarësia.
 - b. Nuk merr pjesë në veprimtaritë kombëtare të FSHB-së për një vit pezullohet, mbi një vit përjashtohet.
 - c. Refuzon ose nuk ka paguar të paktën për 6-muaj të një pasnjëshëm (nga fillimi i vitit buxhetor) detyrimet financiare që rrjedhin nga anëtarësimi në FSHB nga pakujdesia ose me dashje.
 - d. Humbet personalitetin juridik me vendim të organit që e ka miratuar.
 - e. Përjashtohet për shkak të cënimit të rëndë të dispozitave të statutit apo interesave të FSHB-së.
 - f. Ndikon në përkeqësimin e imazhit të FSHB-së dhe pengon zhvillimin e aktiviteteve, programeve/projekteve që zbaton FSHB-ja.
2. Propozimi për pezullimin ose përjashtimin e anëtarit të FSHB-s i takon Sekretarit të Përgjithshëm, i cili nxjerr një vendim të arsyetur bazuar në pikat e mësipërme. Ja paraqet KD-së për miratim. Pas miratimit nga KD-ja, vendimi për pezullim apo për përjashtim i përket vetëm Asamblesë së Përgjithshme.
3. Humbja e cilësisë së anëtarit, nënkupton humbjen e të gjitha të drejtave që lidhen me FSHB-në, por nuk e liron atë nga detyrimet e veta financiare të pa përbushura kundrejt FSHB-së ose anëtarëve të tjera.

President
Avni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani





KREU III

ORGANET DREJTUESE TE FEDERATËS SHQIPTARE TË BASKETBOLLIT,

Neni 13
Organizimi i FSHB-së

FSHB organizohet në baza vullnetare. Organet drejtuese të FSHB-së janë:

1. Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarave, (Asambleja e Përgjithshme)
2. Presidenti
3. Komiteti Drejtues (KD)
4. Sekretari i Përgjithshëm (SP) (si organ administrativ dhe ekzekutiv)

Neni 14

MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E ANËTARËVE (ASAMBLEJA)

1. Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve është organi me i lartë vendimarrës i FSHB-së.
2. Asambleja përbëhet nga tërësia e anëtarëve të regjistruar në regjistrin e anëtarësimit dhe është organi më i lartë vendim-marrës i FSHB-së. Vendimet e saj janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë anëtarët.
3. Asambleja e përgjithshme e zakonshme, mbidhet një herë në vit. Ajo sherben si një analizë vjetore e punës dhe njëkohësisht i ka të gjitha atributet për të marrë vendime të cilat ajo i arsyeton të domosdoshme dhe që janë pjesë e rendit të ditës.
4. Njoftimi për mbajtjen e saj duhet t'i bëhet i ditur anëtarëve 15 ditë përpëra zhvillimit të saj së bashku me rendin e ditës.

President
Avni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani

10





5. Në Asamblenë e Përgjithshme të zakonshme, marrin pjesë anëtarët e KD-së, Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm. Ata ushtrojnë të drejtën e votës vetëm në rastet kur janë të mandatuar nga një anëtar i Asamblesë.
6. Komiteti Drejtues vendos mbi pjesmarrjen e personave të ftuar në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
7. Presidenti ka të drejtë, që të ftojë në Asamblenë e Përgjithshme, Drejtues të Federatave Ndërkontinentale të Basketbollit ose figura të shquara të basketbollit kombëtar, europian dhe botëror.

Neni 15
Thirrja e Asamblesë së Zakonshme

1. Asambleja e zakonshme thirret nga:
 - a. Presidenti;
 - b. 2/3 e Komitetit Drejtues;
 - c. Nga 1/5 e anëtarëve me të drejtë vote.
2. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i FSHB-së, nëpërmjet mënyrave elektronike të komunikimit (e-mail, rrjete sociale, ëwebsite, telefon).
3. Asambleja drejtohet nga Presidenti, ose në mungesë të tij:
 - a. nga anëtari më i moshuar i Komitetit Drejtues.
 - b. nga një person i zgjedhur me shumicën e votave të anëtareve të pranishëm.
4. Proçes-verbali i mbledhjes së Asamblesë, mbahet nga sekretaria e mbledhjes (ngritur për këtë qellim) dhe në prezencën e noterit, i cili vërteton nënshkrimet nga Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm.

President
Aym Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani





Neni 16 Kompetencat e ASAMBLESË

Kompetencat e Asamblesë janë si mëposhtë:

1. Miraton ose refuzon anëtarësimin, pezullimin, dorëheqjen dhe humbjen e statusit të anëtarëve të FSHB-së.
2. Zgjedh dhe shkarkon anetarët e Komitetit Drejtues.
3. Zgjedh dhe shkarkon Presidentin.
4. Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe të strukturës së organizatës.
5. Miraton ose refuzon krijimin e komisioneve të posaçme të ngritura nga KD, sipas përcaktimeve të Nenit 31 të këtij statuti
6. Përcakton kontributin e anëtarësimit dhe kuotën e periodike vjetore.
7. Përcakton fushat dhe programin e veprimtarisë së FSHB-së.
8. Miraton kalendarin e aktiviteteve të programuara nga Komiteti Drejtues.
9. Mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e programeve të miratuara.
10. Nxjerr norma të detyrueshme për anëtarët, në lidhje me rregullimin e veprimtarisë, organizimit dhe strukturës së FSHB-së.
11. Kontrollon rast pas rasti, shpenzimet financiare të kryera nga organizata gjatë realizimit të veprimtarisë së saj, duke përfshirë edhe ato të kryera për veprimtari të përbashkëta me organizata të tjera.
12. Shqyrton çështjet ekonomike dhe financiare dhe çështje të administrimit të FSHB-së.
13. Miraton projekt - buxhetin e FSHB-së dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm.
14. Emëron organin e kontrollit finansiar të pavarur nga FSHB-ja sipas ligjeve në fuqi (Audit).

President
Avni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani





15. Miraton pasqyrat financiare që paraqiten nga Komiteti Drejtues, ku jepen me hollësi burimet materiale e financiare, përdorimet e tyre dhe pasuritë e FSHB-së.
16. Miraton propozimet e anëtarëve për dhënie të titujve të nderit brenda juridiksimonit të federatës.
17. Miraton ndryshimet në Statut.
18. Mbikëqyr veprimtarinë e FSHB-së në përpunthje me legjislacionin në fuqi.
19. Vendos për shkrirjen e Shoqatës dhe emërimin e likuiduesve.
20. Vendos për çështje të tjera parashikuara shprehimisht në ligj, në statut ose që nuk i janë lënë në kompetencë ndonjë organi tjetër.

Neni 17
Kuorumi dhe votimi

1. Punimet e Asamblesë janë të vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 50%+1 e anëtarëve të shoqatës.
2. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm. Çdo anëtar ushtron të drejtën e votës sipas përcaktimeve të bëra në këtë statut.
3. Për ndryshimin e Statutit, shkarkimin e Presidentit, anëtarëve të Komitetit Drejtues dhe për shkrirjen e Shoqatës vendoset me shumicë votash kur janë të pranishëm të paktën $\frac{3}{4}$ dhe votojnë pro mbi 2/3 e këtyre pjesëmarrësve në punimet e Asamblesë.

Neni 18
Rendi i ditës

1. Rendi i ditës i punimeve të Asamblesë përcaktohet nga Komiteti Drejtues.
2. Rendi i ditës përmban propozime të Komitetit Drejtues si dhe çështje që i paraqiten KD-së nga anëtaret jo më vonë se 15 (pesmbëdhjetë) ditë përpëra punimeve të Asamblesë.

President
Avni Ponari

REPUBLICA SHQIPERIA
FEDERATA SPORTIVE
FEDERATION
Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani
Moisaj

Neni 19
Përfaqësimi në Asamble

1. Anëtarët Asamblesë së FSHB-së, nëpërmjet pëfaqësuesit ligjor, mandatojnë zyrtarisht përfaqësuesit e tyre në Asamble. Ato regjistrohen sipas procedurave në FSHB. Çdo përfaqësues i regjistruar ka të drejtën e një vote.
2. Anëtarët me titull individual, janë anëtarë nderi dhe nuk kanë të drejtë vote.
3. Anëtarët e FSHB-së duhet të regjistrojnë në FSHB përfaqësuesit e tyre me të drejtë vote 10 ditë pas zgjedhjes se tyre në Asamblenë lokale, si dhe jo më vonë se 20 ditë përpara datës së zhvillimit të Asamblesë së Përgjithshme të FSHB-së.
4. Përfaqësuesit me të drejtë vote, paraqiten në Asamble duke paraqitur dokumentin zyrtar të identifikimit.
5. E drejta e votës, nuk mund t'i delegohet një anëtar apo përfaqësuesi të një anëtarit tjetër.
6. Perfaqësuesi i regjistruar me të drejtë vote, nuk mund të përfaqësohet nga persona të tjerë në Asamble.

Neni 20
Numri i Përfaqësuesve në Asamble

1. Anëtarët e FSHB-së, sipas përcaktimit të pikes d , Neni 19, këtu e mësipër, kanë të drejtën e një vote në Asamble.
2. Anëtarët, persona juridikë (shoqata, shoqëri, klube basketbolli, etj) përveç votës së parashikuar në pikën 1, këtu e më sipër, kanë edhe nga një votë për skuadër të kategorisë të rritur/a.
3. Kanë një votë më shumë anëtarët, që kanë fituar titullin e fundit kampion (meshkuj ose femra) te rritur ose te rritura.

President
Avmi Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani



Neni 21
Asambleja e Përgjithshme Zgjedhore

1. Asambleja e përgjithshme zgjedhore mblidhet një herë në katër vjet, që përkon me vitin e zhvillimit të lojrave olimpike botërore.
2. Ajo, thërritet nga Presidenti ose në mungesë të tij nga 2/3 e anëtarëve të Komitetit Drejtues.
3. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë, duhet t'i dërgohet anëtarëve të paktën 30 ditë përpara datës së zhvillimit të saj.
4. Ajo duhet që zhvillohet dhe të protokollohet në prezencën e një noteri publik.
5. Vendimet e marra, duhet të depozitohen në gjykatë nga Presidenti ose një përfaqësues (autoritet) ligjor i autorizuar prej tij.

Neni 22
Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme

1. Asambleja e jashtëzakonshme, mblidhet sa herë që shihet e domosdoshme për çeshtje të cilat paraqiten si nevojë urgjente për shqyrtim.
2. Asambleja e jashtëzakonshme, thirret nga Presidenti, nga 2/3 e KD-s, si edhe me kërkesën e të paktën 2/3 e anëtarëve të FSHB-së.
3. Asambleja e jashtëzakonshme, duhet të mblidhet jo më vonë se 2 muaj pas depozitimit të kërkesës së bërë nga 2/3 e anëtarëve të saj.
4. Nëse Asambleja nuk thirret, atehërë anëtarët që e kërkojnë atë, mund ta thërrasin mbledhjen vetë, duke ngarkuar një kryetar të përkohshëm, me një grup pune deri në realizimin e saj.
5. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë së jashtëzakonshme, duhet tu dërgohet anëtarëve, jo më vonë se 30 ditë përpara ditës së zhvillimit të saj.
6. Dokumentat shoqëruese, për çështjet që do të shqyrtohen, sipas rendit të ditës i dërgohen anëtarëve, të paktën 10 ditë përpara datës së mbledhjes.

President
Avni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani





7. Çdo anëtar ka të drejtë të propozojë përfshirjen, në rendin e ditës, të një çështje të caktuar. Kjo kërkesë duhet të paraqitet në sekretariatin e FSHB-së, të paktën 15 ditës para mbledhjes.
8. Asambleja e jashtëzakonshme, shqyrton dhe vendos për çështje të cilat paraqesin urgjencë dhe domosdoshmëri në vendimarrje për mbarëvajtjen e punëve të FSHB-së.

Neni 23
Marrja e Vendimeve

1. Asambleja është e vlefshme kur anëtarët e saj janë thirrur rregullisht dhe kur janë të pranishëm të paktën 50%+1 e anëtarëve me të drejtë vote.
2. Nëse shumica e thjeshtë (50% +1) nuk arrihet, një Asamble tjetër e Përgjithshme duhet të mblidhet jo më parë se 24 orë dhe jo më shumë se 72 orë, pas të parës, me të njejtin rend dite. Nuk kërkohet shumicë për mbledhjen e dytë përveç rasteve kur, në rendin e ditës janë parashikuar ndryshime në statutin e FSHB-së, emërimi ose shkarkimi i Presidentit dhe KD-s, pranimi ose përjashtimi i një anëtarë të FSHB-së, ose shkrirja e FSHB-së, për të cilat kërkohet një shumicë prej 2/3 të votave të anëtarëve të FSHB-së.
3. Asambleja e Përgjithshme, nuk merr vendime për çështje që nuk janë parashikuar në rendin e ditës. Përveç rastit kur të gjithë anëtarët janë të pranishëm dhe të dakortësuar.
4. Vendimet duhet të merren me votim të fshehtë, me përjashtim të rastit kur 2/3 e përfaqësuesve kërkojnë votim të hapur. Në rast votash të barabarta, vota e Presidentit është përcaktuese.
5. Vendimet e marra nga Asambleja, hyjnë në fuqi menjëherë dhe regjistrohen në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë.
6. Vendimet e saj bëhen publike nëpërmjet kanaleve zyrtare të komunikimit të FSHB-së.

President
Ayni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani

16





Neni 24 Presidenti

1. Presidenti është përfaqësuesi ligjor FSHB-së. Ai është përfaqësuesi më i lartë i shoqatës në të gjitha instancat dhe në marrëdhënie me të tretët.
2. Presidenti i FSHB-së, zgjidhet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e anëtareve të FSHB-së.
3. Kandidati për President duhet të:
 - a. Të jetë shtetas Shqiptar me banim në Shqipëri
 - b. Të ketë arsim të Lartë
 - c. Të ketë figurë të pastër morale
 - d. Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë Shqiptare/ose të huaj
 - e. Të mos ketë konflikt interes i postin e Presidentit
 - f. Të ketë kontribuar mundësisht në fushën e sportit, trajner, gjyqtar, gazetar, personalitet publik apo donator (financues).
4. Presidenti zgjidhet për një mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje, sa herë që Asambleja e vlerëson si kandidat të vlefshëm.

Neni 25 Kompetencat e Presidentit

Presidenti ka kompetencë që:

1. Thërrret dhe drejton mbledhjet e Asamblesë dhe KD-së në përputhje me politikat dhe programet e miratuara nga Asambleja si dhe siguron zbatimin e Vendimeve të Asamblesë dhe KD-së.
2. Të marrë përsipër të drejta dhe detyrime në emër të FSHB-së.
3. Të hapë llogari bankare dhe të urdhërojë me autorizime, përdorimin e tyre për të patur të drejtë të kryejë çdo lloj transaksi, tërheqje dhe derdhje në emër dhe përllogari të FSHB-së, në përbushje të interesave të ligjshme.
4. Të autorizojë përtë vepruar në emër dhe përllogari të shoqatës.

President
Avni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani



5. Në raste të veçanta mund të autorizojë Sekretarin e Përgjithshëm për të kryer veprime në emer të shoqatës, në mungesë të tij.
6. Të kontrollojë administrimin e mjeteve financiare dhe pasurinë e shoqatës.
7. Kontrollon përdorimin e fondeve, transferimi i të cilave mund të bëhet vetëm me firmën e Presidentit ose të personave të autorizuar prej tij.
8. Propozon emërimin dhe shkarkimin e Sekretarit të Përgjithshëm.
9. Emëron dhe shkarkon stafin me pagesë të FSHB-së.
10. Raporton para Asamblesë së shoqatës.
11. Emëron dhe shkarkon trajnerët e ekipit kombëtar, pas konsultimeve që ai i mendon të nevojshme.
12. Në rast se Presidenti mungon ose vendi i tij mbetet bosh, detyrat i ngarkohen një personi tjeter të zgjedhur, me votim të fshehtë, nga komiteti drejtues deri në mbledhjen e Asamblesë së rradhës. Në mbledhjen më të afërt të Asamblesë së Përgjithshme.
13. Bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për të siguruar që, organizatat anëtare dhe ato që sigurojnë financim, shërbime dhe mbështetje materiale, nuk përdoren apo manipulohen për qëllime të tjera.

Neni 26 Mandati i Presidentit

1. Presidenti zgjidhet dhe shkarkohet nga asambleja me $50\% + 1$ të votave të anëtarëve të pranishëm.
2. Mandati i Presidentit është katër vjeçar, fillon që nga dita e zgjedhjes se tij nga Asambleja me $50\% + 1$ të votave të anëtarëve të pranishëm, konstituimit nga gjykata e rrëthit gjyqësor Tiranë dhe mbaron:
 - a. Ditën kur Asambleja ka votuar për zgjedhjen e një Presidenti të ri me $50\% + 1$ të votave të anëtarëve të pranishëm dhe kryerjes së proçdurave ligjore.
 - b. Kur ka dhënë dorëheqjen nëpërmjet një deklarimi me shkrim.

President
Avni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani



- c. Kur Asambleja me kërkesë të motivuar ka votuar sipas procedurave të nenit 17 pika "c", për shkarkimin e tij, në rastet kur ai shkel statutin ose veprimet e tij nuk përputhen me veprimtarinë e FSHB-së dhe e demtojnë rëndë, materialisht ose moralisht atë.

Neni 27
Komiteti Drejtues

1. Komiteti Drejtues është organ ekzekutiv. Vendimet e tij janë të zbatueshme në periudhën mes dy asambleve të FSHB-së:
 - a. Ai siguron mbarëvajtjen financiare të organizatës dhe ushtrimin e veprimtarisë së saj në përputhje me qëllimin e deklaruar.
 - b. Harton dhe propozon rregulloret e funksionimit të FSHB-së, aktivitetet e sportive, komisioneve të ngritura për rregullimin e çështjeve të caktuara si dhe zbaton çdo vendim të miratuar në Asamblenë e Përgjithshme.
 - c. Thërret mbledhjen e Asamblesë me miratimin e 2/3 të anëtarëve të tij.
 - d. Propozon rendin e ditës për tu diskutuar në mbledhjet e Asamblesë bashkë me propozimet konkrete.
 - e. Miraton kalendarin e aktiviteteve të programuara.
 - f. Përgatit dhe dërgon për miratim në Asamble, pasqyrat financiare ku jepen me hollësi burimet materiale e financiare, përdorimet e tyre dhe pasuritë e FSHB-së.
2. Komiteti Drejtues zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme për një mandat 4-vjeçar me të drejtë rizgjedhje dhe përbëhet nga një numër prej 7 anëtarësh, përfshirë dhe Presidentin e FSHB-së.
3. Anëtarët e Komitetit Drejtues duhet të:
 - a. Jenë shtetas shqiptarë dhe me banim në Shqipëri.
 - b. Të kenë arsim të lartë.
 - c. Të kenë figurë të pastër morale.
 - d. Të mos jenë dënuar nga organet e drejtësisë Shqiptare dhe të huaj.

President
Avni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani



- e. Të mos jenë njëkohësish, trajnerë, gjyqtarë, vëzhgues, apo anëtarë tëndonjë organi gjykues të FSHB-së.
 - f. Të mos jenë njëkohësish anëtarë në një federatë tjeter, anëtarë komisioni, kolegjumi, etj.
 - g. Të mos jenë të dënuar nga një federatë sportive për thyerje discipline, përdorim doping apo për abuzime financiare.
 - h. Të jenë propozuar nga një anëtar i FSHB-së.
 - i. Të mos ketë konflikt interesash me të qenit anëtar i KD-së.
 - j. Të kenë aftësi të spikatura në sport, menaxhim, ekonomi, drejtësi, drejtim, biznes të shoqëruara me çertifikata dhe tituj akademikë.
4. Anëtarët që propozojnë kandidatin nuk duhet të jenë të pezulluar.
5. Emrat e kandidatëve bashkë me CV-të e tyre, duhet të dërgohen nga anëtarët, në sekretariatin e FSHB-së sipas afateve të përcaktuara, shoqëruar me një letër motivimi dhe mos pasjen e konfliktit të ineresit.
6. Sekretariati verifikon kandidaturën dhe dokumentacionin, referuar kushteve të kandidimit dhe ja paraqet rezultatet KD-së për miratim.
7. Lista e aprovuar e kandidatëve, të cilët plotësojnë kushtet, i paraqitet anëtarëve të FSHB-së së bashku me Rendin e Ditës së Asamblesë.
8. Një anëtar i FSHB-së nuk mund të propozojë më shumë se 1 kandidat për anëtar të KD-së.

Neni 28

Mbledhjet dhe Vendimarrja e Komitetit Drejtues

1. Komiteti Drejtues mblidhet jo më pak se 6 herë në vit, si dhe sa herë konsiderohet e nevojshme.
2. Mbledhjet e tij drejtohen nga Presidenti dhe në mungesë të tij, nga Sekretari i Përgjithshëm.
3. Mbledhjet e Komitetit thërriten nga Presidenti, ose nga shumica e anëtarëve të KD-së.
4. Njoftimi për mbledhje i dërgohet anëtarëve, jo më vonë se 7 ditë para zhvillimit të mbledhjes (me përjashtim të rasteve urgjente dhe atyre me fuqi madhore).
5. Në mbledhjet e komitetit drejtues, mund të marrin pjesë edhe specialistë të ndryshëm, të ftuar për të dhënë mendime, për çështje të rendit të ditës.

President
Avni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani



6. Për mbledhjet e KD-së, mbahet proces verbal i cili firmoset nga Presidenti dhe Sekretari Përgjithshëm.
7. Mbledhjet dhe vendimet e Komitetit Drejtues, janë të vlefshme kur në të marirn pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në rastin e votave të barabarta Presidenti ka votë vendimtare.
8. Anëtarët e Komitetit Drejtues duhet që të marrin pjesë rregullisht në mbledhje. Kur një anëtar mungon në mbledhje, 3 herë rradhazi pa arsyte të forta, humbet mandatin dhe zëvëndësohet nga kandidati I rradhës, që ka fituar më shumë vota në garën zgjedhore.
9. KD-ja ka fuqi vendim-marrëse në periudhat nga një asamble në tjetrën. Vendimet e marra i paraqiten asamblesë së rradhës për miratim kur është e nevojshme.

Neni 29
Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm është drejtuesi ekzekutiv i FSHB-së.
2. Ai mund të zgjidhet ndërmjet anëtarëve të Komitetit Drejtues ose jashtë tyre.
3. Kur zgjidhet nga KD-ja, vendin e tij në KD e zë kandidati me numër më të madh votash dhe që ka arritur pragun e votave për të qenë anëtar i KD-së.
4. Sekretari i Përgjithshëm duhet:
 - a. Të jetë shtetas shqiptar me banim në Shqipëri
 - b. Të ketë Arsim të Lartë
 - c. Të ketë figurë të pastër morale
 - d. Të ketë moshë mbi 30 vjeç
 - ç. Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare apo të huaj
 - e. Të mos jetë njëkohësisht, trajner, gjyqtar, vëzhgues, sekretar klubit apo anëtar i një organi gjykues të FSHB-së
 - f. Të mos jetë njëkohësisht, anëtar i një federate tjeter (anëtar komisioni), kolegjiumi, etj.
 - g. Të mos jetë i dënuar nga ndonjë federatë tjeter sportive, për thyerje discipline, përdorim doping, apo abuzime financiare.
 - gj. Të mos ketë konflikt interesash me të qenit Sekretar i Përgjithshëm.
5. Sekretari i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga KD-ja me propozim të Presidentit ose të më shumë se 1/2 së anëtarëve të këtij komiteti.

President
Avni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani



Neni 30
Kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm


Sekretari i Pergjithshëm duhet:

1. Të bëjë preqatitjet për Asamblenë e Përgjithshme dhe për mbledhjet e KD-së, e të organeve të tjera të FSHB-së.
2. Të zbatojë vendimet e Asamblesë dhe KD-së .
3. Të organizojë dhe drejtojë të gjithë veprimtarinë e përditshme administrative dhe financiare të FSHB-së.
4. Të merret me organizimin e brendshëm duke hartuar rregulloret përkatëse dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe funksionimin e administratës së FSHB-së, si edhe drejtimin e saj.
5. Të organizojë mbajten korrespondencës dhe arshivës.
6. Të koordinojë punën e grupeve të punës.
7. Të hartojë kontratat e punës, shërbimeve, partneriteteve etj.
8. Të kontrollojëqë veprimtaria e FSHB-së të jetë në përputhje me statutin.
9. Të vëzhgojë zbatimin statutit dhe rregulloreve, nga anëtarët dhe propozon për rastet e shkeljeve të kryera prej tyre, sipas rregullave të përcaktuara në statut.
10. Sekretari i Përgjithshëm, raporton përpara Asamblesë, KD-së dhe Presidentit, sa herë i kërkohet një gjë e tillë.

Neni 31
Komisionet

1. Komisionet krijohen me propozim të KD-së për rregullimin e një sektori apo çeshtje të caktuar të cilat miratohen në Asamble të Përgjithshme.
2. Kohëzgjatja dhe mënyra e funksionimit të tyre përcaktohet me propozim të KD-së dhe miratim të Asamblesë së Përgjithshme.
3. Anëtarët e këtyre komisioneve përzgjidhen më shumicë votash në KD sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara nga KD-ja.
4. Pranë FSHB-së funksionojnë komisione të përherëshme dhe të përkohëshme përmbrashjen e qellimeve të saj. Komisione të përherëshme janë:
 - a. Komisioni i disiplinës: merret me shqyrtimin e zbatimit të rregullores së aktiviteteve të basketbollit, të organizuara nga FSHB. Ai mblidhet dhe funksionon sipas problematikave dhe relacioneve që paraqesin për shqyrtim, vëzhguesit e garave si dhe anëtarët pjesmarrës në gara.

President
Ayni Ponari



Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani




- b. Komisioni i apelit: merret me shqyrtimin e ankimimeve të vendimeve të komisioneve respektive.
- c. Komisioni i gjykimit: merret me edukimin, kualifikimin dhe klasifikimin e gjyqtarëve dhe vëzhguesve të basketbollit. Ai merr pjesë me sugjerimet e veta, në përzgjedjen e gjyqtarëve në veprimtaritë e FSHB-së.
- d. Komisioni i garave: merret me hartimin e projekteve të edicioneve sportive në karakter kombëtar dhe lokal, si dhe merret me organizimin dhe manaxhimin e aktiviteteve ndërkontinentale që zhvillohen në vendin tonë apo vende të tjera. Ai merret dhe me logjistikën e grumbullimeve të ekipeve kombëtare, gjatë periudhave të preqatijes dhe udhëtimeve të tyre.

Neni 32 Shqyrtimi administrativ dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. FSHB shqyrton në formë administrative zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në komisionet e ngritura për këtë qëllim (disiplinës, gjykimit dhe garave) vendimet e të cilëve ankimohen në komisionin e apelit. Vendimet e komisionit të Apelit ankimohen sipas përcaktimeve të Neni 33.
2. Organet e gjykimit disiplinor të FSHB-së shqyrtojnë dhe vendosin masa ndëshkuese ndaj pjesëmarrësve në veprimtaritë sportive, që kryejnë shkelje disiplinore ose teknike, në kundërshtim me statutin, rregulloren e veprimtarisë dhe/ose me rregulloren e disiplinës.
3. Vendimet e organeve disiplinore të Federatës njoftohen nëpërmjet adresave elektronike subjekteve/anëtarëve të cilet kanë interes të drejtë për drejtë. Njoftimi shpallet në faqen zyrtare elektronike dhe rrjetet sociale të FSHB së.
4. Vendimet e marra mund të ankimohen brenda 72 oreve pranë organit të shkallës së dytë, apelit të ngritur për këtë qellim pranë FSHB-së.

Neni 33 Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS)

Vendimet e komisionit të apelit të FSHB-së janë të detyrueshme për anëtarët e saj, kur ato kanë marrë formë të prerë. Vendimet mund të ankimohen në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv (KAS) brenda 15(pesmbëdhjetë) ditësh nga shpallja e vendimit.

Vendimet e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv janë të detyrueshme për tu zbatuar nga palët.

President
Ayni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani

23





Neni 34 Lufta Anti - Doping

1. Federta Shqiptare e Basketbollit në zbatim të ligjit 79\2017, njeh Organizatën Kombëtare Antidoping (OKAD) si autoritetin e vetëm në Republikën e Shqipërisë e njojur nga (WADA), që merret me kontrollin e përdorimit të lëndëve të ndaluara në sport.

2. Aktiviteti i saj, irregullohet dhe mbështetet sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të ndërsjellë për sportin e basketbollit ndërmjet FSHB-së dhe OKAD-s.

3. Çdo anëtar i FSHB-së është i detyruar që t'i përgjigjet pozitivisht në çdo moment kontrolleve të organizuara nga ky autoritet.

Neni 35

Kontrolli Mjekësor 1. Anëtarët e FSHB-së, janë të detyruar që sportistët që përbëjnë skuadrat e tyre duhet të janë të pajisur me çertifikatën e kontrollit mjekësor nga mjekë të autorizuar.

2. Asnjë sportist nuk mund të marrë pjesë në veprimtaritë e FSHB-së pa e pasur një raport të tillë.

Neni 36 Parandalimi i dhunës në Sport

2. Shoqatat organizatore të veprimtarive sportive, janë të detyruara të ndërmarrin të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për sigurimin e veprimtarive basketbollistike dhe në veçanti të kujdesen për marijen e masave parandaluese dhe të shfaqjes së provokimeve apo sjelljeve të tjera të palejuara.
3. Gjatë veprimtarive sportive/basketbollistike të të gjitha niveleve janë të patoloreruara dhe të dënueshme, sulmi fizik ndaj pjesmarrësve në aktivitete sportive, qofshin këto pjesmarrës, sportistë, trajnerë apo organizatorë.
4. Çdo shfaqje që cënon aktivitetin sportiv nëpërmjet dhunës është e pasqyruar me hollësi në rregulloret vjetore të aktiviteteve të FSHB-së.

President
Avni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani



Neni 34
Lufta Anti - Doping

1. Federta Shqiptare e Basketbollit në zbatim të ligjit 79\2017, njeh Organizatën Kombëtare Antidoping (OKAD) si autoritetin e vetëm në Republikën e Shqipërisë e njojur nga (WADA), që merret me kontrollin e përdorimit të lëndëve të ndaluara në sport.

2. Aktiviteti i saj, rregullohet dhe mbështetet sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të ndërsjellë për sportin e basketbollit ndërmjet FSHB-së dhe OKAD-s.

3. Çdo anëtar i FSHB-së është i detyruar që t'i përgjigjet pozitivisht në çdo moment kontrolleve të organizuara nga ky autoritet.

Neni 35
Kontrolli Mjekësor

1. Anëtarët e FSHB-së, janë të detyruar që sportistët që përbëjnë skuadrat e tyre duhet të jenë të pajisur me çertifikatën e kontrollit mjekësor nga mjekë të autorizuar.


2. Asnjë sportist nuk mund të marrë pjesë në veprimtaritë e FSHB-së pa e pasur një raport të tillë.

Neni 36
Parandalimi i dhunës në Sport


2. Shoqatat organizatore të veprimtarive sportive, janë të detyruara të ndërmarrin të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për sigurimin e veprimtarive basketbollistike dhe në veçanti të kujdesen pë marrjen e masave parandaluese dhe të shfaqjes së provokimeve apo sjelljeve të tjera të palejuara.
3. Gjatë veprimtarive sportive/basketbollistike të të gjitha niveleve janë të patoloreruara dhe të dënueshme, sulmi fizik ndaj pjesmarrësve në aktivitete sportive, qofshin këto pjesmarrës, sportistë, trajnerë apo organizatorë.
4. Çdo shfaqje që cënon aktivitetin sportiv nëpërmjet dhunës është e pasqyruar me hollësi në rregulloret vjetore të aktiviteteve të FSHB-së.



President
Ayni Ponari



Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani



duhen përdorur asnjëherë për të siguruar përfitime direket dhe/ose indirekt për asnje nga themeluesit, Presidentin apo anëtarët e Komitetit Drejtues, anëtarët e FSHB-së, etj.

3. Ky ndalim nuk përjashton pagesën e arsyeshme që mund t'u behet personave që punojnë për FSHB-në.

Neni 39
Ndalime të veçanta

FSHB nuk pranon dhurata dhe nuk aplikon për fonde tek persona juridikë a fizikë, vendas ose të huaj te cilët shkelin hapur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut apo kryejnë ndonjë aktivitet që cënon dispozitat e këtij statuti.

Neni 40
Gjatësia e ushtrimit të aktivitetit finansiar

Viti ushtrimor i Shoqatës, fillon nga 1 Janari deri në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik

Neni 41
Mbajtja e kontabilitetit dhe auditimi

1. FSHB mban kontabilitetin sipas legjisacionit shqiptar në fuqi, nga financieri i emëruar nga Presidenti.
2. Auditimi finansiar kryhet nga ekspertë kontabël të licencuar, të cilët caktohen nga Komiteti Drejtues.

Neni 42
Mbyllja e bilancit finansiar

Në fund të çdo viti, financieri i ngarkuar nga Presidenti i FSHB-së, bën mbylljen e inventarit dhe të bilancit finansiar. Bilanci përfundimtar duhet të pasqyrojë qartësisht, për kapituj të veçantë, drejtimin ekonomik – finansiar të FSHB-së.

President
Avni Ponari



Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani

KREU V
DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 43
Rregulla të Përgjithshme

1. Kur mbledhja e asamblesë së përgjithshme behet e pamundur, për shkaqe madhore si fatkëqesi natyrore, gjendje e jashtëzakonshme apo pandemie, mandati i organeve drejtuese zgjatet përsa kohë që shkaqet do të ekzistojnë. Por jo më vonë se 3 deri 6 muaj nga dita e shpalljes së gjendje normale.
2. Vendimet e organeve të FSHB-së, me përjashtim të rasteve të veçanta të parashikuara në këtë statut, merren me shumicë votash kur janë të pranishëm me shumë se 1/2 e anëtarëve të atij organi.
3. Zgjedhjet për organet drejtuese të FSHB-së, bëhen në bazë të dy ose me shumë kandidaturave dhe me votim të fshehtë.
4. Të gjitha vendimet e Asamblesë dhe të Komitetit Drejtues të FSHB-së protokollohen.

Ndryshimet statutore miratohen nga ministri përgjegjës për sportin brenda 60 ditëve nga data e depozitimit, përpara kërkesës për regjistrim në gjykatën kompetente. Pas kalimit të këtij afati, statuti konsiderohet i miratuar në heshtje.

Neni 44
Konflikti i interesave

1. Nuk lejohen për asnjë arsyе, konfliktet e interesave në FSHB. Të interesave private të anëtarëve të organeve drejtuese të FSHB-së dhe/ose interesave private të personave te punësuar nga FSHB.

President
Avni Ponari

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani



2. Marrëveshjet ose transaksionet financiare të shoqatës, në të cilat një anëtar i organeve drejtuese të FSHB-së ose një punonjës, për interesa private, përjashtuar raste të veçanta kur:
 - a. Transaksi apo marrëveshja bëhet për të përm bushur një qëllim ose objektiv që është në përputhje me qëllimin e veprimitarës së FSHB-së.
 - b. Anëtari i organit drejtues apo i punësuari prej FSHB-së, deklaron interesat private të tij dhe tërhiqet nga proçesi vendimmarrës konkret.
 - c. Organi drejtues shqyrton plotësisht transaksionin apo marrëveshjen.
 - d. Transaksi apo marrëveshja, orientohet sipas vlerës reale të tregut ose në terma favorizues për FSHB-në.
3. Në rastet kur një transaksi është kryer apo një marrëveshje është lidhur në kushtet e konflikteve të interesit, FSHB ka të drejtë, t'a quajë të pavlefshëm transaksionin/marrëveshjen dhe të ngrejë padi kundër shkaktarëve dhe/ose përfituesve për dëmshpërbirim.

KREU VI

SHKRIRJA/MOSFUNKSIONIMI I FSHB-SË


Neni 45 Transformimi dhe bashkimi i FSHB-së

Transformimi i FSHB-së ose bashkimi i saj me shoqata të tjera për përfitimin reciprok të tyre, mund të vendoset vetëm nga Asambleja e Jashtëzakonshme me miratimin e 2/3 se të gjithë anëtareve.


Neni 46 Shpërndarja

1. Shpërndarja e FSHB-së behet kur:

- a. Asambleja vendos për mbylljen e aktivitetit të FSHB-së;
- b. Asamblejakonstaton se qëllimi i FSHB-së është përm bushur ose nuk ka mundësi të përm bushet;
- c. Veprimitaria e FSHB-së rezulton në kundërshtim me qëllimin e themelimit të saj;




President
Avni Ponari



28

Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani





- d. Vërtetohet se FSHB ka filluar të ushtrojë veprimitari të kundërligjshme;
 - e. Në çdo rast tjetër të parashikuar me ligj.
2. Vendimi për shpërndarjen e FSHB-së, merret me shumicën e cilësuar prej $\frac{3}{4}$ të gjithë anëtarëve të saj, ose/dhe me vendim të gjykatës.


Neni 47
Likuidimi

Kur vendoset shpërndarja e FSHB-së, ajo ç'regjistrohet, pushon veprimtarinë e saj dhe vihet në likuidim nga komisioni i likuidimit, i cili formohet dhe vepron në bazë të ligjeve në fuqi. E gjithë pasuria e FSHB-së, i shperndahet shoqatave të tjera të ngjashme që kanë të njejin qëllim dhe mision.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 48

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, aplikohet statuti dhe rregulloret e FIBA-s si dhe normat e legjislacionit Shqiptar në fuqi.


President
Avni Ponari



Sekretar i Përgjithshëm
Korab Llazani
